



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1333/5 prot.

Datë 10/07/2023

V E N D I M

Nr. 585/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10/07/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK” në procedurën e prokurimit “Proçedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65937-04-13-2023, me objekt: “Ndërtimi i shkalleve Llapushaj”, me fond limit 2,499,896 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Ankimues: BOE “PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK”
Adresa: Lagja “Sporti”, Zona kadastrale nr 1842, Pallati 8/287- 2 Kati përdhe, Gramsh.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gramsh
Adresa: Bulevardi “10 korriku”, Gramsh.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.04.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Proçedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65937-04-13-2023, me objekt: “Ndërtimi i shkalleve Llapushaj”, me fond limit 2,499,896 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

II.2. Më datë 27.04.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 05.06.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. "2 SRL GROUP" SHPK	2.422.900 leke	kualifikuar
2. BOE "PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK"	2.664.554 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 05.06.2023, bashkimi i operatorëve ekonomikë "PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK" është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

"1. BOE "PERPARIMI/G shpk & 2 N" shpk

Në kriteret e kualifikimit është kërkuar;

2.3.6. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Për ofertuesin 2N SHPK me nipt L31615017L, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik 2N SHPK:

- Nuk ka arritur të plotësojë pikën 2.3.6 (e), deklaratën për vendodhjen dhe verifikimin e automjeteve nga autoriteti kontraktor në raste Bashkia Gramsh.

PERPARIMI-G

Në kriteret e kualifikimit është kërkuar;

2.3.4 *Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:*

- a) 1 (nje) Teknik ndërtimi*
- b) 1(nje) elektrikist*
- c) 2(dy) punonjes betonues*
- d) 2 Suvatues/murator*
- e) 1(një)Punonjes Manovratore Patente Manovrimi nga DPSHTRR.*
- f) 2 (dy)shofere*

Nisur nga preventivi i punimeve që do të kryej operatorë ekonomik PERPARIMI-G nuk përmbushë kriterin e vendosur në DST, konkretisht Piken 2.3.4 (c)- 2(dy) punonjes betonues.

Ne preventivin e punimeve te OE PERPARIMI-G thuhet se do te kryhen "Transport material inerte deri ne 5 km, 178 m³", nderkoh ne kriteret e vendosur ne DST. Shtojca 8 nuk ka deklaruar asnje shofer i cili do kryej transportin.

BOE PERPARIMI-G & "2N" shpk ka dorezuar listpagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi, Shkurt 2023 ku rezulton se.

P.N dhe F.Z te punesuar si Betonues sipas vetdeklarimit te OE 2N SHPK rezulton ne baze te listpageses i punesuar me kodin 7115.02 si karpentier, nderkoh duhet te jete me kodin 7114.01. K.M i punesuar si shoferi kompanis, sipas vetdeklarimit te OE 2N SHPK rezulton ne baze te listpageses i punesuar me kodin 8322.01, nderkoh duhet te jete me kodin 8332.14.

BOE PERPARIMI-G & "2N" shpk kane plotesuar gabim formularin e ofertes ku preventivi eshte plotesuar mbi Shtojca 10, ku ne fakte sipas formatit te DST ky formular plotesohet nga autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh.

Sa me sipër BOE PERPARIMI-G & "2N" shpk nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.6, (e) 2.3.4 (c, f), të kriterëve te vendosura ne DST sipas shpjegimeve te permendura me siper.

Per sa me siper, mbeshetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, ku shprehimisht parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, oferta e BOE PERPARIMI-G & "2N" shpk skualifikohet."

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se më datën 06.06.2023 është publikuar Njoftimi i Fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit, ku fitues është shpallur shoqëria "2 S R L GROUP" SHPK.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 09.06.2023, bashkimi i operatorëve ekonomikë "**PËRPARIMI-G SHPK & 2N SHPK**" ka paraqitur ankesë njëkohësisht si pranë autoritetit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik me objekt kundërshtimin e veprimeve të komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimit të ofertës së paraqitur prej bashkimit të operatorëve ekonomikë "**PËRPARIMI-G & 2N**" SHPK, si më poshtë vijon:

"Në datën 27.04.2023 autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh zhvilloi procedurën e hapur të thjeshtuar të prokurimit me objekt: "Ndërtimi i shkallëve Llapushaj", me fond limit 2.499.896 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) leke pa TVSH ku shoqërite BOE "PËRPARIMI/G" shpk & "2N" shpk u paraqitën si ofertues, duke ofertuar për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve me çmimin e ofertës në vlerën prej 2,220,462

lekë pa TVSH. Pas shqyrtimit të Vlerësimit të Ofertave Autoriteti Kontraktor vendosi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga shoqëritë BOE “PËRPARIMI/G” shpk & “2N” shpk.

Vlerësimi i bërë nga Komisioni i Prokurimeve Publike është i pakuptimtë pasi në Fazën e Vlerësimit të Tenderit ku në këtë procedurë kanë konkuruar vetëm 2 shoqëri të cilat janë: “2 S R L GROUP” dhe BOE “PËRPARIMI/G” shpk & “2N” shpk , paraqitja e vlerave të ofertuara nuk është e drejtë. Shoqërisë “2 S R L GROUP” i është paraqitur vlera totale e ofertës pa TVSH, konkretisht 2,422,900 leke, ndërsa shoqërive BOE “PËRPARIMI/G” shpk & “2N” shpk i është paraqitur vlera totale e ofertës me TVSH, konkretisht 2,664,554 leke.

Operatori Ekonomik	Vlerat të ofertuara	Refuzuar	Arsye
2 S R L GROUP	2422900.00	Jo	
PERPARIMI/G	2664554.00	Po	Në kriteret e kualifikimit është kërkuar: 2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikim

Në dokumentat e ngarkuara në sistem APP, në formularin e ofertës janë dhënë çmimet totale të ofertës si më poshtë:

Çmimi total i ofertës sonë pa TVSH: 2,220,462 leke.

Çmimi total i ofertës sonë me TVSH: 2,664,554 leke.

Më poshtë po ju paraqesim Njoftimin e Fituesit ku vërtetohet ajo çfarë thamë më sipër.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “2 S R L GROUP” shpk
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera 2 422 900 (dymilionë e katërqind e njëzetë e dymijë e nëntëqind) lekë, pa TVSH.

M02116011A
Numri i NIPT-t

2. BOE “PERPARIMI/G” shpk & “2 N”shpk
Emri i plotë i shoqërisë

J66702835G & L31615017L
Numri i NIPT-t

Vlera 2 220 462 (dymilionë e dyqind e njëzetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy)lekë, pa TVSH.

Gjithë sa më sipër, kërkojmë nga ana e Autoritetit Kontraktor bazuar në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020. “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe në VKM-në nr.284 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” të rishikojë kualifikimin e shoqërisë tjetër pjesëmarrëse në këtë procedurë, pasi vendimi i Komisionit të Vleresimit të Ofertave është i padrejtë dhe i pabazuar ne ligj. Në rast të kundërt jemi të detyruar ti drejtohem Komisionit të Prokurimit Publik.”.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1333/2 prot, datë 12.06.2023.

II.8. Me shkresën nr. 2103/1 prot, datë 16.06.2023 me objekt: “Kthim përgjigje ankesës” dërguar në sistemin elektronik të ankesave nga ana e autoritetit kontraktor dhe të protokolluar me tonën me nr. 1333/3 prot, datë 16.06.2023, si dhe po me shkresën nr. 2103/1 prot, datë 16.06.2023 me objekt: “Kthim përgjigje ankesës” dërguar në rrugë postare nga ana e autoritetit kontraktor dhe të protokolluar me tonën me nr. 1333/4 prot, datë 19.06.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “**PËRPARIMI-G SHPK & 2N SHPK**” për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës, ku ndër të tjera ka argumentuar se: “... Vlerësimi paraprak: Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës konstatoi se operatori ekonomik ankimes ka interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Rrethanat e çështjes

Në datën 14.04.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Ndërtimi i shkallëve Llapushaj”, me nr. REF-65937-04-13-2023, me fond limit 2 499 896 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë)lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.04.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Në datën 05.06.2023, janë njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave të tyre për këtë procedurë prokurimi dhe po në datë 05.06.2023 është

hedhur në SPE Formulari i Njoftimit të Fituesit Paraparak dhe në datë 06.06.2023 është bërë Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Më datë 12.06.2023, Personi Përgjegjës për Prokurimet konstaton se në bazën e të dhënave në faqen zyrtare të KPP është paraqitur ankesë lidhur me vlerësimin e tenderit me objektin e sipërcituar, ankesë e cila regjistrohet në bashki me nr.2103 prot datë 12.06.2023. KSHA nga verifikimi në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik konstatohet se ankesa është dorëzuar në KPP më datë 09.06.2023 ora 08:16:57 , duke respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton se;

Në nenin Neni 111 të LPP parashikohet se “ Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”

Neni 112 i LPP parashikon se “ Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni”.

VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar parashikon se:

Neni 94/1 parashikon se “Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Neni 94/2 “Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Neni 96 “Veprimet paraprake të autoritetit/entit kontraktor”

1. Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.

Neni 100/1 “Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti/enti kontraktor”

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës , konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk ka dorëzuar ankesë pranë Autoritetit Kontraktor , Bashkia Gramsh në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit KSHA konstatoi gjithashtu se ankimuesi është skualifikuar nga procedura për mosplotësim të kriterëve të kualifikimit të vendosura nga Autoriteti Kontraktor , dhe nuk kundërshton arsyet e skualifikimit të ofertës së tij, por pretendon se vlera e ofertuar prej tij në këtë procedurë prokurimi është shënuar gabim nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

KSHA konstatoi se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ofertën e tij në vlerën 2 220 462 (dymilionë e dyqind e njëzetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, pa TVSH, ndërsa nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është shënuar gjatë vlerësimit në SPE vlera me TVSH 2 664 554 lekë, me TVSH.

KSHA konstatoi gjithashtu se në Formularin e njoftimit të fituesit (paraparak), i publikuar edhe në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) vlera e ofertës së ankimuesit është shënuar saktë sic ai ka ofertuar, 2 220 462 (dymilionë e dyqind e njëzetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy)lekë, pa TVSH, ku janë pasqyruar edhe arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

Sa më sipër, KSHA arsyeton se pavarësisht shënimit gabim të vlerës së ofertës së ankimuesit , të dhënat e tjera të dokumentuara e të publikuara pasqyrojnë vlerën e saktë të ofertës së tij.

Gjithashtu ankimuesi pavarësisht pretendimit të tij, nuk kundërshton arsyet e skualifikimit të ofertës së tij, pasi ai është skualifikuar nga procedura për arsyet e pasqyruara në SPE dhe në Formularin e Njoftimit të fituesit (paraparak) të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr.53 datë 12.06.2023.

Për sa më sipër, gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik ankimues pas arsyetimit të KSHA-së mbetet e skualifikuar, pasi pretendimet e tij nuk ndryshojnë gjendjen juridike të tij.

Sa u analizua më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave :

VENDOSI

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Përparimi./G“shpk & “2N” shpk , për procedurën “E hapur e thjeshtuar ”, me objekt “ Ndërtimi i shkallëve Llapushaj”, me nr. REF-65937-04-13-2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.04.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

2. Personi Përgjegjës për Prokurimet të njoftojë ankuesin dhe Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me këtë vendim.”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*”, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, nisur nga njoftimi i skualifikimit i datës 05.06.2023 të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*”, për mos pasqyrimin e saktë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave në njoftimin e skualifikimit të datës 05.06.2023, të vlerës së ofertës së ofruar nga ana e ankimuesit në procedurën e prokurimit objekt-ankeseskualifikimin e ofertës së tij me pretendimin se: “*Vlerësimi i bërë nga Komisioni i Prokurimeve Publike është i pakuptimtë pasi në Fazën e Vlerësimit të Tenderit ku në këtë procedurë kanë konkuruar vetëm 2 shoqëri të cilat janë: “2 S R L GROUP” dhe BOE “PËRPARIMI/G” shpk & “2N” shpk , paraqitja e vlerave të ofertuara nuk është e drejtë. Shoqërisë “2 S R L GROUP” i është paraqitur vlera totale e ofertës pa TVSH, konkretisht 2,422,900 leke, ndërsa shoqërive BOE “PËRPARIMI/G” shpk & “2N” shpk i është paraqitur vlera totale e ofertës me TVSH, konkretisht 2,664,554 leke.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në datën 14.04.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-65937-04-13-2023, me objekt:

“Ndërtimi i shkalleve Llapushaj”, me fond limit 2,499,896 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

III.1.3. Më datë 27.04.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin elektronik të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë dorëzuar ofertat e tyre ekonomike, si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------------|------------------------|
| 1. BOE “PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK” | 2.220.462 leke pa-TVSH |
| 2. “2 SRL GROUP” SHPK | 2.422.900 leke pa-TVSH |

III.1.5. Në datën 05.06.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

“... Për shpejtësi veprimesh, kërkesa e mësipërme (shkresa zyrtare) mund t’i dërgohet edhe në formë elektronike me anë të butonit “Kërkesë e re”. Më pas, me marrjene një përgjigje zyrtare me shkrim nga operatori ekonomik, anëtari i KVO duhet të kalojë në vlerësimin ekonomik të ofertave, duke klikuar tek butoni “Kuotim”. Në dritaren që shfaqet, anëtari i KVO duhet që në fushën Cmimi (tvsh e përjashtuar) të vendosë vlerën e ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik pa TVSH (vlerën e korigjuar, nëse ka pasur korigjime). Në fushën Justifikimi/Arsyeja mund të vendosë një koment në lidhje me ofertën ekonomike (p.sh oferta ekonomike e korigjuar, marzhi i fitimit, etj.) ...”.

Sa më sipër, KPP gjykon, se mos pasqyrimi i saktë i vlerës së ofertës ekonomike (pa përfshirë vlerën e TVSH-së) të dhënë nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK” në njoftimin e skualifikimit të datës 05.06.2023 të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga ana e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore aktualisht në fuqi dhe të rregullave të prokurimit publik. KPP gjykon, se anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave në njoftimin e skualifikimit të datës 05.06.2023 duhet të kishin pasqyruar vlerën e saktë të ofertës ekonomike (pa përfshirë vlerën e TVSH-së) të dhënë nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK”, referuar Shtojcës 1 “Formulari i ofertës” të dorëzuar nga ana e këtij operatori ekonomik. KPP veprimin e datës 05.06.2023 të autoritetit kontraktor e gjen, jo në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të vlerësimit të ofertave të paraqitura. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efiçencës parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK”, të bazuar në ligj.

Për sa më sipër pretendimi i mësipërm i bashkimit të operatorëve ekonomikë “PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK” qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*” për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*2 SRL GROUP*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstaton se ky i fundit nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak se nuk gëzon asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi.

III.2.1. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 05.06.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ <i>2 SRL GROUP</i> ” SHPK	2.422.900 leke	kualifikuar
2. BOE “ <i>PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK</i> ”	2.664.554 leke	skualifikuar

III.2.2. Në datën 05.06.2023, bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*” është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“1. BOE “PERPARIMI/G shpk & 2 N” shpk

Në kriteret e kualifikimit është kërkuar;

2.3.7. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Për ofertuesin 2N SHPK me nipt L31615017L, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik 2N SHPK:

- Nuk ka arritur të plotësoj piken 2.3.6 (e), deklaratën për vendodhjen dhe verifikimin e automjeteve nga autoriteti kontraktor në raste Bashkia Gramsh.

PERPARIMI-G

Në kriteret e kualifikimit është kërkuar;

2.3.4 *Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:*

- g) 1 (nje) Teknik ndërtimi*
- h) 1(nje) elektrikist*
- i) 2(dy) punonjes betonues*
- j) 2 Suvatues/murator*

k) *1(një)Punonjes Manovratore Patente Manovrimi nga DPSHTRR.*

l) *2 (dy)shofere*

Nisur nga preventivi i punimeve qe do te kryej operatore ekonomik PERPARIMI-G nuk permbush kriterin e vendosur ne DST, konkretisht Piken 2.3.4 (c)- 2(dy) punonjes betonues. Ne preventivin e punimeve te OE PERPARIMI-G thuhet se do te kryhen “Transport material inerte deri ne 5 km, 178 m³”, nderkoh ne kriteret e vendosur ne DST. Shtojca 8 nuk ka deklaruar asnje shofer i cili do kryej transportin.

BOE PERPARIMI-G & “2N” shpk ka dorezuar listpagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi, Shkurt 2023 ku rezulton se.

P.N dhe F.Z te punesuar si Betonues sipas vetdeklarimit te OE 2N SHPK rezulton ne baze te listpageses i punesuar me kodin 7115.02 si karpentier, nderkoh duhet te jete me kodin 7114.01. K.M i punesuar si shoferi kompanis, sipas vetdeklarimit te OE 2N SHPK rezulton ne baze te listpageses i punesuar me kodin 8322.01, nderkoh duhet te jete me kodin 8332.14.

BOE PERPARIMI-G & “2N” shpk kane plotesuar gabim formularin e ofertes ku preventivi eshte plotesuar mbi Shtojca 10, ku ne fakte sipas formatit te DST ky formular plotesohet nga autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh.

Sa me sipër BOE PERPARIMI-G & “2N” shpk nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.6, (e) 2.3.4 (c, f), të kritereve te vendosura ne DST sipas shpjegimeve te permendura me siper.

Per sa me siper, mbeshetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, ku shprehimisht parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, oferta e BOE PERPARIMI-G & “2N” shpk skualifikohet.”.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se më datën 06.06.2023 është publikuar Njoftimi i Fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit, ku fitues është shpallur shoqëria “2 S R L GROUP” SHPK.

III.2.4. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.2.5. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar,

në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.2.6. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.2.7. Në nenin 94, pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.2.8. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se autoriteti kontraktor në datë 05.06.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ku bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*”, rezulton i skualifikuar. Gjithashtu, në datë 06.06.2023, është publikuar në sistemin elektronik të prokurimit njoftimi i fituesit paraprak i kësaj procedure prokurimi, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “*2 S R L GROUP*” SHPK. Në datën 09.06.2023, bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*” ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave vetëm në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*2 S R L GROUP*” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, por nuk ka ngritur asnjë pretendim për sa i përket skualifikimit e ofertës së tij ekonomike.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor i cili ka vendosur për skualifikimin e ofertës së këtij të fundit. Brenda afateve të parashikuara të ankimit në nenin 110 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ankimuesi ka parashtruar pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Ligjvënësi në nenin 110 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” ka parashikuar afate strikte mbi paraqitjen e ankesës, afate të cilat për nga natyra juridike janë prekluzive. Kështu, pas përfundimit të afatit të ankimit të vendosur në ligj, në kushtet kur operatori ekonomik nuk ka pasur pengesë në ushtrimin e të drejtës së ligjshme të ankimit, vendimi i autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij është përfundimtar dhe nuk mund të rishikohet nga një organ tjetër administrativ.

Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për tu dëmtuar nga një shkelje e pretenduar. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar me një vendim përfundimtar nga autoriteti kontraktor për të cilën ky i fundit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se LPP parashikon në mënyrë eksplicite, se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrjnë të drejtën e tyre të ankimit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjitha elementet formale sipas dispozitave ligjore. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*”, ka paraqitur pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “*2 S R L GROUP*” SHPK dhe nuk ka kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, duke humbur kështu të drejtën për tu ankimuar për skualifikimin e tij brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligji.

Referuar përcaktimeve ligjore si më sipër cituar, kërkohet që ankimuesi, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.8. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është, që përmes ankimit ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit dhe nuk e ka kundërshtuar këtë fakt, duke humbur kështu të drejtën për tu ankimuar brenda afateve ligjore, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë rezulton i skualifikuar dhe nuk e ka ankimuar këtë fakt. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Kështu që rrjedhimisht, operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar, për sa kohë vetë rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt-ankimi, duke mos gëzuar asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi në kuptim të nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. *REF-65937-04-13-2023*, me objekt: “*Ndërtimi i shkalleve Llapushaj*” me fond limit 2,499,896 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.
 2. Të konstatoj absolutisht të pavlefshëm njoftimin e skualifikimit të datës 05.06.2023 të Komisionit Vlerësimit të Ofertave lidhur me pasqyrimin jo të saktë të vlerës së ofertës ekonomike të paraqitur nga ana e bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*” dhe të rikthejë procedurën në gjendjen fillestare vetëm për këtë operator ekonomik ankimues në mënyrë që të kryejë vlerësimin e tij në përputhje me parashikimet e udhëzimit nr. 07, datë 30.07.2021 “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*”.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*PERPARIMI/G SHPK & 2N SHPK*”.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fioorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

